



Pranuar / Doretur / Prilidhen / Prilidato / Received / Delivery	30.01.2023	3	viti / god / year
Organ / Njësia / Organi / Jednica / Org. Unit	Nr. Prof. / Pr. Prof. No.	Shtesa / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
KPMShCK	1093/2023		113



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1207/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Kqca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1207/2022 të datës 16.12.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted], me adresë fshati Shalë Komuna e Lipjanit, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1, nenin 16 paragrafi 3 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1207/2022 e datës 16.12.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Shërbimi Korrektues i Kosovës, më datë 07.11.2022 ka publikuar njoftimin për shpallje të konkursit me Nr. Reference:RN000010323 për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i sektorit për punë juridike dhe të përgjithshme", ku afati për aplikim rrjedh nga data 22.11.2022 deri më datë 29.11.2022.

Ankuesi më datë 16.12.2022 përmesë emailit në ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë me numër protokollit 8160/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet që sistemi online për aplikim duhet të jetë i barabartë për të gjithë shërbyesit civil dhe jo diskriminues.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 11.01.2023 ankesën e ankuesit e ka dërguar



për përgjigje, ne ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Ndërsa Këshilli më datë 19.01.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. protokoll 8160/2022 të datës 16.12.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkurs Ngritje (avancim) në detyrë në Shërbimin Korrektues të Kosovës për pozitën "Udhëheqës i sektorit për punë juridike dhe përgjithshme" i datës 07.11.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 543/2023 e datës 19.01.2023; Shkresat e lëndës për ankesën A.nr.1207/2022 me numër protokoll 082 i datës 19.01.2023; Akt Emërim i F. Sh. i datës 13.01.2017; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 20.01.2020; Lista e aplikantëve nga SIMBNJ për pozitën "Udhëheqës i sektorit për punë juridike dhe përgjithshme"; Njoftim nga Njësia e Burimeve Njerëzore i datës 01.12.2022; Njoftim nga Njësia e Burimeve Njerëzore e rezultateve të vlerësimit i datës 16.12.2022; Vendim për emërimin e komisionit përzgjedhës i datës 06.12.2022; Konfirmim për përfundimin e konkurimit i datës 27.12.2022; Akt Emërim i P.R. i datës 27.12.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 11.01.2023; Fletëkthesë e datës 13.01.2023;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi, se ankesë e ankuesit është e palejuar, *sepse*:

Bazuar në shkresat e lëndës, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit i cili pretendon se gjatë aplikimit për pozitën "Udhëheqës i sektorit për punë juridike dhe të përgjithshme" në Shërbimin Korrektues të Kosovës gjithçka ka qenë në rregull dhe se i njëjti ka pritur që do ta thërrasin në intervistë, pasi që intervista është mbajtur me datë 14.12.2022 dhe të njëjtit nuk e kanë ftuar në intervistë, ankuesi pretendon që sistemi online për aplikim duhet të jetë i barabartë për të gjithë shërbyesit civil dhe jo diskriminues. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se as ankuesi po ashtu as Shërbimi Korrektues i Kosovës nuk ka dërguar asnjë dëshmi me të cilën do të dëshmonte që ankuesi ka aplikuar në konkursin me Nr. Reference RN00010323 i datës 07.11.2022 për Ngritje (avancim) në detyrë në Shërbimin Korrektues të Kosovës për pozitën "Udhëheqës i sektorit për punë juridike dhe përgjithshme", si rrjedhojë meqenëse ankuesi nuk ka dëshmi që ka aplikuar në këtë pozitë, si dhe për t'a shqyrtuar në mënyrë të drejtë pretendimin e ankuesit duke u bazuar në përgjigjen në ankesë me numër protokoll 082 të datës 19.01.2023 nga Menaxheri i Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës se në Konkursin Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i sektorit për punë juridike dhe përgjithshme" në Shërbimin Korrektues të Kosovës në Qendrën e paraburgimit në Lipjan përmes sistemit SIMBNJ ka aplikuar vetëm kandidati Përparim Rushiti dhe gjatë kësaj procedure nuk ka pasur asnjë ankesë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me këtë çështje juridike-administrative, duke ju referuar Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 125 paragrafi 1, i cili përcakton se: "Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative"), rrjedhimisht ankuesi ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk e ka parashtruar kundër një akti administrativ apo ndonjë mosveprimi të institucionit, për shkak që nuk ka parashtruar asnjë kërkesë që institucioni ka qenë i obliguar t'i përgjigjet, për me tepër meqenëse ankuesi nuk ka dëshmuar me asnjë provë që ka aplikuar në konkursin me Nr.



Reference RN00010323 i datës 07.11.2022 për Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i sektorit për punë juridike dhe përgjithshme" përmes portali për rekrutimit elektronik, atëherë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se të njëjtit nuk i është cenuar asnjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës apo të njëjtit nuk i është mohuar asnjë e drejtë në këtë procedurë, rrjedhimisht pala ankuese nuk ka legjitimitet për parashtrimin e ankesës dhe për pretendimet kundër një procedure që nuk ka qenë pjesë e saj siç parashihet me nenin 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim..." si dhe ndërlidhur me nenin 14 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të këtij ligji.


Andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ankesa e parashtruar nga ankuesi është e papranueshme.

Si me sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1207/2022

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

